



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimit / Dorezuar / Prilbena / Prudato / Received / Delivery	14.09.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinstvo / Org / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSTICK	5389/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.681/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.681/2022 të datës 02.08.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit KA.nr.35/2022 të datës 20.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.681/2022 e datës 02.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. **Shfuqizohet** Vendimi KA.nr.35/2022 i datës 20.07.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- III. **Anulohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 04.04.2022 për ankuesen.
- IV. Sipas këtij vendimi, Vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 mbetet i njëjtë me vlerësimin e rezultateve në punë të vitit 2020.
- V. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan sipas Akt Emërimit të datës 22.02.2017 në pozitën „Zyrtare Ligjore“, më datë 04.04.2022 i është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, të cilën ankuesja e ka pranuar më datë 17.06.2022, ndërsa kundër këtij vlerësimi më datë 22.06.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen E Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 20.07.2022 ka nxjerr Vendim KA.nr.25/2022 me të cilin ka hedhë poshtë të parakohshme ankesën e ankuseses.

Ankuesja kundër Vendimit KA.nr.35/2022 të datës 20.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes postës më datë 29.07.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 02.08.2022 dhe është regjistruar me Nr.Port:4469/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.08.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuseses nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli më datë 15.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4469/2022 e datës 02.08.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.35/2022 të datës 20.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 04.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 15.08/2022; Ankesën e datës 22.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2021; Akt Emërimit të datës 22.02.2017; Kërkesën për informata e datës 29.08.2022 dhe Përgjigjen e datës 31.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuseses është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, gjegjësisht vlerësimi i është bërë jashtë afatit ligjor dhe kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas administrimit të shkresave të lëndës konstaton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 22.02.2017 është e punësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan në pozitën „Zyrtare Ligjore“, ndërsa më datë 04.04.2022 i është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 me notë të përgjithshme 2.0, të cilën ankuesja e ka pranuar më datë 17.06.2022. Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 33 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se: *“Në çdo institucion të administratës qendrore dhe komunale kryhet periodikisht, në fund të çdo viti, vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë. Vlerësimi i rezultateve në punë kryhet me qëllim të rritjes së suksesit të punës dhe për të siguruar përmirësimin gradual të aftësisë profesionale dhe të cilësisë së shërbimeve administrative. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë mbështetet në verifikimin e realizimit të objektivave të caktuara në fillim të periudhës së vlerësimit nga nëpunësi. Vlerësimi i rezultateve në punë është i detyrueshëm për mbikëqyrësit. Moskryerja mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore”,* dhe nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *“Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1.4 Periudha e vlerësuar, nënkupton periudhën për të cilën vlerësohen rezultatet e punës së nëpunësit civil dhe përfshin periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor. 1.5. Periudha e vlerësimit, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe zgjat nga 1-31 dhjetor të vitit të vlerësuar”,* rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankueses vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 në baze të formularit i është bërë më datë 04.04.2022, jashtë afatit të përcaktuar ligjor, respektivisht në kundërshtim me normat e lartcekura.

Gjatë shqyrtimit të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesja, konkretisht formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 04.04.2022, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se tek rubrika ku shënohet „pozita e punës së vlerësuesit “përshkruhet që është „Administratore“, ndërsa tek rubrika ku shënohet, vlerësuesi (emri dhe mbiemri)“ është shënuar emri i cili e ka bërë dhe nënshkruar vlerësimin në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, ndërsa ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 22.02.2017 është e punësuar në pozitën „Zyrtare Ligjore“ dhe si mbikëqyrëse të drejtpërdrejt e ka Administratoren e Gjykatës Themelore në Gjilan e cila e ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020. Nga provat e administruara, Kolegji nuk ka gjetur asnjë akt me të cilin ankuesja është ngarkuar me detyra shtesë si asistente e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, ndërsa tek rasti i vlerësimit tek vlerësimi i objektivave ankuesja është vlerësuar vetëm për pozitën që e mban

sipas Akt Emërimit të datës 22.02.2017 ashtu siç përcaktohet me nenin 5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, rrjedhimisht nuk është vlerësuar për një pozitë tjetër, në këtë rast Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 i datës 04.04.2022 është bërë nga personi jo kompetent dhe në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1.3. Vlerësuesi, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil, i cili bën vlerësimin e rezultateve të punës së tij"*.

Marr për bazë dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, si dhe provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen ka qenë i iniciuar me shkelje të shumta procedurale sepse në asnjë pikë nuk janë respektuar afatet ligjore dhe procedurat e përcaktuara me këtë rregullore, andaj nisur nga këto shkelje është e pamundur që ky vlerësim të jetë i ligjshëm dhe objektiv.

Sa i përket Vendimit KA.nr.35/2022 të datës 20.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të cilin ankuesja e konteston me ankesë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky vendim është nxjerr me shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka arritur të shqyrtoj drejtë gjendje faktike dhe juridike për faktin që me rastin e vendimmarrjes nuk është bazuar në faktet vendimtare që kanë rezultuar të merret një vendim i tillë, respektivisht nuk ka arritur të vërtetojë drejtë që vlerësimi është bërë jashtë afatit ligjor dhe nga organi jo kompetent, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Vendimin me numër KA.nr.35/2022 të datës 20.07.2022, e ka nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Nga të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqë konstatoj se në këtë proces të vlerësimit për ankuesen ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të aplikueshme në fuqi, atëherë sipas këtij vendimi vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 do të jetë i njëjtë me vlerësimin e rezultateve në punë si për vitin 2020.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.681/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

